Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0580

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (OE)"Internat Security Association" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te ish MPMS-se"me nr. të prokurimit:"201-22-14626-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Administrata e Qendres – Ministria e Finacave, Punes dhe Transfereve, me datën 11/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Hedhet si e palejuar,** ankesa e operatorit ekonomik, "Internat Security Association" SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 14.08.2023 me numër protokolli 580/2023 për aktivitetin e prokurimit , lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te ish MPMS-se " me nr. të prokurimit: "201-22-14626-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Administrata e Qendres – Ministria e Finacave, Punes dhe Transfereve.

2. Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (**Res Judicata**) pasi që pretendimet ankimore në këtë ankesë janë të njëjta si në Vendimin PSh. nr.113/23 i datës 24.03.2023, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar "**Res Judicata**", konform nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP.

3. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues hedhet si e pa lejuar, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës.Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 27.12.2022, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te ish MPMS-se” me nr. të prokurimit: "201-22-14626-2-2-1". Nderkaq me datën 26.07.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

(OE) “Internat Security Association” SH.P.K. me datën 30.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Me datën 02.08.2023, AK- Administrata e Qendres – Ministria e Finacave, Punes dhe Transfereve me vendim ka refuzuar kërkesën per rishqyrtim te OE- “Internat Security Association” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve te ish MPMS-se” me numër te prokurimi “201-22-14626-2-2-1"te inicuar nga. AK- Administrata e Qendres – Ministria e Finacave, Punes dhe Transfereve.

AK ne vendim ka kërkuar te Refuzohet si e pabazuar kërkesa per rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Internat Security Association” SH.P.K. me datën 14.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 580/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: sherbim, vlera e parashikuar e kontratës:**101,800.00** €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 01.09.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të OE ankues janë të njejta me ankesën e datës 24.03.2023 me nr. 2023/0113, për të cilën kam përgatitur dhe dorëzuar raportin me datën 10.03.2023. (pjesa Fakte dhe argumente, jan të njejta pretendime me ankesën e datës 24.03.2023) e për të cilën ankesë, Paneli shqyrtues ka nxjerrë VENDIM me numër: OSHP: 2023/0113 me datë 18.05.2023. Andaj sipas vlerësimit tim kjo çështje është gjykuar, gjithnjë duke u bazuar në nenin 67..1 të Rregullorës për Prokurim Publik, nr. 001/2022 e në përputhje me nenin 105 të LPP-së par.2.16. i cili shprehimisht sqaron se: Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta

ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me piken 16 të paragrafit 2 të nenit 105, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, palëve në procedurë Paneli konstatoi në vijim se:

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesave, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tije i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Marr parasysh faktin se Paneli Shqyrtues me datën 18.05.2023, ka marr vendim 2023/0113, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e OE ankues dhe paneli ka vërtetuar vendimin e AK sipas pikës 1 të dispozitivit, por si gabim teknik i lëshuar në fund të kësaj pike të dispozitivit citohet "anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim", ky gabim i mbetur nga hartuesit e vendimeve nuk është evidentuar më parë, por AK ka qenë dashtë të lexoj në përpikëri arsyetimin e vendimin dhe përfundimin e këtij vendimi ku paneli shqyrtues ka konstatuar se ankesa është komplet e pa bazuar dhe AK ka respektuar dispozitat ligjore të LPP dhe shumë e lehtë ka qenë të konstaohet se vendimi nuk e kthen lëndën në ri-vlerësim, përveç kësaj, nëse jo OSHP apo ndonjë palë në procedurë, AK ka qenë dashtë me evidentu këtë lëshim teknik dhe të kërkoj sqarime nga OSHP, e jo ta kthej lëndën në ri-vlerësim. Gabime/lëshime teknike gjithmonë mund të ndodhin dhe janë të kuptueshme, por palët e interesuara gjithmon kanë të drejtën që të drejtohen me kërkesë me sqarime në OSHP dhe nëse evidentohen këto lëshime, atëherë, OSHP ka të drejtën të dal me konkluzione për të përmirësuar të njëjtat, konform nenit 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Ligji nr. 05/L-031. Andaj, në këtë rast AK si përgjegjëse e këtij aktiviteti të prokurimit, ka qenë dashur ta marrë përgjegjësinë dhe të kujdeset për mbarëvajtjen e aktivitetit të prokurimit dhe të kërkojë sqarime nga OSHP.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues, Paneli mori parasysh faktin se palë në procedurë për aktivitetin e prokurimit në fjalë sipas vendimit të lartcekur kanë qenë autoriteti kontraktues Administrata e Qendres – Ministria e Finacave, Punes dhe Transfereve, dhe operatori ekonomik i njëjtë ankues.

Paneli Shqyrtues ka marr një vendim meritor lidhur me pretendimet ankimore të OE "Internat Security Association" SH.P.K të ngritura në ankesën e datës: 27.02.2023 (protokoll 2023/0113). Andaj ankesa nga OE ankues"Internat Security Association" SH.P.K e datës 14.08.2023, (protokoll 2023/0580) konsiderohet si çështje gjykuar nga ana panelit shqyrtues të OSHP-së.

Lidhur me ketë, duhet theksuar se në paragrafin 2.16 të-nenit 105 të LPP, përkufizohet shprehimisht **Res Judikata**, sipas të cilit "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Parimi i sigurisë juridike, në drejtim të:

Res judicata, pasi vendimi Psh. Nr. 2023/0113 i datës 18.05.2023, është i formës së prerë dhe nuk mund të diskutohet nga një panel tjetër. Vendimet e panelit shqyrtues të OSHP-së për kalimin e çështjes për gjykim nuk konsiderohen të ndërmjetme, por janë të një lloji *sui generis*, të detyrueshme për palët në procedurë, duke sjellë pasoja *res judicata* për palët për sa i përket pranueshmërisë së rekursit.

- *Përfundim –*

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe paragrafin 2 pika 16 të nenit 105 të Ligjit të cituar dhe ankesën e parashtruara nga OE "Internat Security Association" SH.P.K e hedhë si te pa lejuara dhe pretendimet e OE ankues i trajtoj si çështje e gjykuar (res judicata) në përputhshmëri me dispozitën e cekur si më lart.

Vendimi si në pikën 3 të dispozitivit u morë për shkak se AK këtë lëndë nuk ka qenë dashtë ta kthej në ri-vlerësim dhe të nxjerrë vendim tjetër.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **ADMINISTRATA E QENDRËS - MINISTRIA E FINANCAVE,PUNËS DHE TRANSFEREVE**
- OE - **"Internat Security Association"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: